

Statistikat e transportit*

Mars 2021

Tiranë, më 27 Prill 2021: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Mars 2021 është 370.8 mijë ton, duke u rritur 45,7 %, krahasuar me Mars 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është rritur 13,5 %.

Në tremujorin e parë vitit 2021, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 1.080,4 mijë ton, duke u rritur me 14,5 %, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020.

Në muajin Mars 2021, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2.706 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 4,2 %, krahasuar me Mars 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është rritur me 11,9 %.

Në tremujorin e parë vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 8.103 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 6,2 %, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Me det/ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër/ton*
Mars 2018	293.037	1.645	174
Mars 2019	432.833	3.011	200,3
Mars 2020	254.384	2.597	155,6
Mesatarja Mars (2018-2020)	326.751	2.418	177
Mars 2021	370.759	2.706	176,8
Ndryshimi vjetor (%)	45,7	4,2	13,6
Ndryshim Mars 2021 / Mesatarja Mars (2018-2020)	13,5	11,9	0,1
Janar-Mars 2020	943.311	8.642	511,5
Janar-Mars 2021	1.080.362	8.103	449,5
Ndryshimi vjetor (%)	14,5	-6,2	-12,1

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në muajin Mars 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 176,8 ton, duke u rritur me 13,6 %, në krahasim me Mars 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me ajër është rritur me 0,1%.

Për publikim 27/04/2021

Në tremujorin e parë të vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 449,5 ton duke u ulur me 12,1 %, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020.

Në Mars 2021, numri i fluturimeve të kryera është 1.128 duke shënuar një rritje me 22,3 %, në krahasim me Mars 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020, numri i fluturimeve është ulur me 26,1 %.

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Mars 2018	19	1.802	9.731
Mars 2019	18	1.856	10.399
Mars 2020	16	922	6.600
Mesatarja Mars (2018-2020)	18	1.527	8.910
Mars 2021	16	1.128	4.236
Ndryshimi vjetor (%)	0,0	22,3	-35,8
Ndryshim Mars 2021 / Mesatarja Mars (2018-2020)	-9,4	-26,1	-52,5
Janar-Mars 2020	16	4.744	28.048
Janar-Mars 2021	16	3.138	12.430
Ndryshimi vjetor (%)	0,0	-33,9	-55,7

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në Mars 2021, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 26.054 pasagjerë. Krahasuar me Mars 2020, ky tregues është rritur 60,8 %. Krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është ulur me 29,9 %.

Në tremujorin e parë të vitit 2021, kanë udhëtuar me linjë detare 88.302 pasagjerë, duke u ulur me 29,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në muajin Mars 2021, transporti ajror i pasagjerëve zë 75,7 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Mars 2021 është 82.872 pasagjerë duke u rritur me 8,9 %, krahasuar me Mars 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është ulur me 48,2 %.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në tremujorin e parë të vitit 2021 është 241.450 pasagjerë duke u ulur me 53,2 %, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Mars 2018	3.475	45.560	192.162
Mars 2019	3.993	49.776	212.034
Mars 2020	0	16.206	76.106
Mesatarja Mars (2018-2020)	2.489	37.181	160.101
Mars 2021	490	26.054	82.872
Ndryshimi vjetor (%)	-	60,8	8,9
Ndryshim Mars 2021 / Mesatarja Mars (2018-2020)	-80,3	-29,9	-48,2
Janar-Mars 2020	64	125.810	515.506
Janar-Mars 2021	1.182	88.302	241.450
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	1.746,9	-29,8	-53,2

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Mars 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 96,2 mld lekë dhe 47,9 % e tyre u transportua me det. Në tremujorin e vitit 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 242,4 mld lekë dhe 50,5% e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Mars 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 51,9 %, me rrugë 36,5 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Mars 2021 janë rritur me 59,9 %, krahasuar me Mars 2020. Eksportet e mallrave të transportuara me rrugë në Mars 2021 janë rritur 30,2 %, krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Mars 2018	15.921,3	0,9	8.766,1	86,9	2.305,6
Mars 2019	16.655,9	-	10.647,5	69,1	447,5
Mars 2020	10.356,9	0,0	7.233,3	75,9	144,7
Mesatarja Mars (2018-2020)	14.311,4	0,3	8.882,3	77,3	965,9
Mars 2021	16.467,1	-	11.563,4	56,8	3.629,8
Ndryshimi vjetor (%)	59,0	-	59,9	-25,1	2.408,4
Ndryshim Mars 2021 / Mesatarja Mars (2018-2020)	15,1	-	30,2	-26,5	275,8
Janar-Mars 2020	40.794,9	-	23.583,9	314,3	1.138,7
Janar-Mars 2021	46.276,0	1,3	27.899,4	186,4	5.861,0
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	13,4	-	18,3	-40,7	414,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në tremujorin e parë të vitit 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 57,7 %, me rrugë 34,8 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 18,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Mars 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Mars 2021, mallrat e importuara me det zënë 46,0 %, me rrugë 49,9 % dhe me ajër 3,3 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Mars 2021 janë rritur me 62,6 %, krahasuar me Mars 2020. Importet e mallrave të transportuara me rrugë në Mars 2021 janë rritur 53,1 %, krahasuar me mesataren e muajve Mars për periudhën 2018-2020.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Mars 2018	29.686,5	236,3	23.503,8	1.475,9	372,1
Mars 2019	18.662,7	211,8	19.800,6	1.407,7	1.707,8
Mars 2020	21.209,6	211,8	19.812,1	1.416,3	1.723,9
Mesatarja Mars (2018-2020)	23.186,3	220,0	21.038,8	1.433,3	1.268,0
Mars 2021	29.664,7	236,6	32.207,2	2.100,4	287,7
Ndryshimi vjetor (%)	39,9	11,7	62,6	48,3	-83,3
Ndryshim Mars 2021 / Mesatarja Mars (2018-2020)	27,9	7,5	53,1	46,5	-77,3
Janar-Mars 2020	68.965,3	862,1	59.594,1	4.161,1	4.463,8
Janar-Mars 2021	76.022,1	918,7	76.673,4	4.879,7	3.669,5
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	10,2	6,6	28,7	17,3	-17,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në tremujorin e parë të vitit 2021, mallrat e importuara me det zënë 46,9 %, me rrugë 47,3 % dhe me ajër 3,0 %. Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 28,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Mars 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT

Metodologji

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve, sipas llojeve, si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit, në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007) është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash